

VENDIM
Nr.970, datë 30.9.2009

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E
PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT MINISTRISË SË
FINANCIVE, TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI NË KTHESËN E KAMZËS, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit Ministrisë së Financave, të sipërfaqes 85 000 (tetëdhjetë e pesë mijë) m², në parcelën nr.68, në zonën kadastrale 2 679, në fshatin Mëzez, të regjistruar në vëllimin 4, faqe 161, të ndodhur në kthesën e Kamzës, Tiranë, me pronar shtetin, për t’u përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

2. Vendimi nr.11, datë 10.1.2007 i Këshillit të Ministrave “Për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të sipërfaqes së truallit në kthesën e Kamzës, Tiranë”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha